



Pranuar / Dorezuar Pritshja/Prodato Received/Delivery	01-09	2023	3	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Puleg Appendix	Sasia Kolicitna Quantity	
SKANSHEK	5927	/2023	1/7	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.911/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.911/2023 të datës 05.07.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Azem Jashanica" Nr.16, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, në çështjen juridike "masë disiplinore-largim nga shërbimi civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 01.09.2023 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.911/2023 e datës 05.07.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër reference Ref.07/04/8/2023 i datës 01.06.2023 i Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, sipas Akt Emërimit me numër Nr.02/2018 të datës 02.03.2018 në pozitën e punës "Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm" në Sektorin e Auditimit, më datë 27.04.2023, Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë në cilësinë e Mbikëqyrëses të Drejtpërdrejtë ka parashtruar kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore në

Komisionin Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë me arsyetimin se i njëjti nuk i ka përmbushur detyrat e punës dhe nuk e ka respektuar orarin e punës për një kohë të gjatë.

Komisioni Disiplinor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë pas zhvillimit të procedurës disiplinore më datë 01.06.2023 ka nxjerr Vendimin me numër të referencës Ref.07/04/8/2023 përmes të cilit ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore duke shqiptuar masën disiplinore „Largim nga Shërbimi Civil“

Ankuesi kundër Vendimit me numër të referencës Ref.07/04/8/2023 të datës 01.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, më datë 03.07.2023 përmes postës me numër R 5466647 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është pranuar më datë 05.07.2023 dhe është protokolluar me numër protokollit 5017/2023, me pretendimin ankimor se Vendimi i Komisionit Disiplinor përmban shkelje procedurale, konstatim të gabuar të gjendjes faktike si dhe shkelje të së drejtës materiale.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.07.2023 Këshilli ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Ndërsa Këshilli më datë 24.07.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me Vendimin me numër të protokollit 5696/2023 të datës 17.08.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.911/2023 të datës 05.07.2023 edhe dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5017/2023 të datës 05.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 21.07.2023; Akt Emërimi me numër Nr.02/2018 i datës 01.03.2018; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 27.09.2017; Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2022 me numër protokollit Nr.2633 i datës 22.06.2023; E-mail i J.M drejtuar B.S i datës 01.06.2023; Procesverbal nga takimi i komitetit të auditimit me numër nr.2150/2 i datës 19.09.2022; Ekstrakt i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit të Auditimit në MBPZHR i datës 21.07.2022; Shkresë për shqyrtimin e kërkesës me numër Nr.07/4 e datës 02.05.2023; E-mail i V.Ç drejtuar J.M i datës 18.03.2023; E-mail i F.P drejtuar B.S; E-mail i V.Ç drejtuar A.N, B.S, F.SH, I.L, I.K,M.G,N.Z,N.V,Z.I e datës 12.04.2023; E-mail i A.N drejtuar M.B, M.B e datës 28.04.2023; E-mail i V.Ç drejtuar A.N, M.B, M.B, M.B e datës 27.04.2023; E-mail i F.P drejtuar B.S e datës 26.04.2023; Vendimi me numër reference Ref.07/04/81/2023 i datës 01.06.2023; E-mail i J.M drejtuar B.S e datës 16.05.2023; E-mail nga J.M drejtuar A.N, M.B, M.B e datës 17.05.2023; E-mail nga J.M drejtuar B.S; Procesverbal

me numër Nr.3076 i datës 31.05.2023; Procesverbal me numër Nr.3088 e datës 31.05.2023; Procesverbal me numër Nr.3104 i datës 01.06.2023; Procesverbal me numër Nr.3105 i datës 01.06.2023; Raport i orëve për periudhën kohore 01.01.2022 deri më 30.04.2023; ; Raport i orëve për periudhën kohore 01.04.2023 deri më 30.04.2023; ; Raport i orëve për periudhën kohore 01.03.2023 deri më 31.03.2023; E-mail nga V.Ç drejtuar N.Z i datës 15.05.2023; E-mail i datës 28.04.2023 i B.S drejtuar F.P; E-maili i datës 01.02.2023; E-mail i datës 31.01.2023; Procesverbal me numër 07/4/3104 i datës 01.06.2023; E-mail i datës 19.07.2022; E-mail i 19.07.2022; E-mail i datës 24.10.2022; E-mail i datës 21.10.2022; E-mail i datës 24.10.2022; E-mail i 21.12.2022; E-mail i datës 16.12.2023; E-mail i datës 19.11.2021; E-mail i datës 22.08.2022; E-mail i datës 19.11.2021; E-mail i datës 17.01.2022; E-mail i datës 19.11.2022; E-mail i datës 06.08.2021; E-mail i datës 24.04.2023; E-mail i datës 14.02.2023; E-mail i datës 22.08.2022; E-mail i datës 08.06.2022; E-mail i datës 31.12.2021; E-mail i datës 14.04.2023; Aprovim i Pushimit Vjetor; Minutat e takimit të rregullt të Drejtoreshës ekzekutive me drejtorat më datë 03.05.2023; E-mail i datës 16.05.2023; E-mail i datës 23.03.2023; E-mail i datës 22.05.2023; E-mail i datës 08.05.2023; E-mail i datës 01.02.2021; Minutat e takimit të rregullt të Drejtoreshës Ekzekutive me drejtorat më datë 20.03.2023; E-mail i datës 03.04.2023; Raporti Javor i Aktiviteteve në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për periudhën kohore 08-12 maj 2023; ; Raporti Javor i Aktiviteteve në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për periudhën kohore 02-05 maj 2023; ; Raporti Javor i Aktiviteteve në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për periudhën kohore 24-28 prill 2023; Raporti Javor i Aktiviteteve në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për periudhën kohore 18-20 prill 2023; ; Raporti Javor i Aktiviteteve në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për periudhën kohore 12-14 prill 2023; ; Raporti Javor i Aktiviteteve në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për periudhën kohore 03-07 prill 2023; ; Raporti Javor i Aktiviteteve në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për periudhën kohore 27-31 mars 2023; ; Raporti Javor i Aktiviteteve në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për periudhën kohore 20-24 mars 2023; ; Raporti Javor i Aktiviteteve në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për periudhën kohore 13-17 mars 2023; Raportet Javore të punës së Zyrës së Auditimit të Brendshëm; Raport Javor i Punës për periudhën 05.07-09.07.2021; Raport Javor i Punës për Periudhën 08.02-12.02.2021; Raport Javor i Punës për periudhën 01.02-05.02.2023; Raport Javor i Punës për periudhën 25.01-29.01.2021; Raport Javor i Punës për periudhën 18.01-22.01.2023; Raport Javor i Punës për periudhën 11.01-15.01.2021; Raport i Auditimit të Veçantë me Kërkesë të Ministrit të MBPZHR; Raporti i Auditimit të Brendshëm i datës 07.09.2021; Raport i Auditimit të Brendshëm i datës 18.01.2022; Raport i Auditimit të Brendshëm i datës 16.02.2023; Raport i Auditimit të Brendshëm i datës 16.02.2023; Raport i Auditimit të Brendshëm i datës 25.04.2023; Plani Strategjik i Auditimit për periudhën kohore 2021-2025; Mesazhe të datës 30.12.2021; E-mail i datës 31.01.2022; Plani Strategjik i Auditimit të Brendshëm për periudhën kohore 2022-2026; E-mail i datës 21.02.2022; E-mail i datës 31.12.2021; E-mail i datës 12.12.2022; E-mail I datës 21.12.2023; Plani Strategjik i Auditimit të Brendshëm për periudhën kohore 2023-2027; E-mail i datës 24.02.2023; E-mail i datës 17.06.2021; E-mail i datës 16.06.2021; E-mail i datës 09.06.2021; E-mail i datës 07.06.2021; Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve i datës 17.06.2021; E-mail i datës 16.06.2021; E-mail i datës 12.08.2022; Regjistri i Menaxhimit të Rezikut i datës 27.01.2023; E-mail i datës 16.02.2023; E-mail I datës 16.02.2023; E-mail i datës 10.02.2023; E-mail i datës 16.02.2023; E-mail i datës 13.05.2022; E-mail i datës 10.05.2022; E-mail i datës 24.06.2021; E-mail i

datës 16.11.2021; E-mail i datës 18.11.2021; E-mail i datës 27.10.2021; E-mail i datës 09.04.2021; E-mail i datës 31.01.2022; E-mail i datës 24.05.2021; E-mail i datës 05.03.2021; E-mail i datës 08.04.2021; E-mail i datës 08.07.2021; E-mail i datës 26.05.2021; E-mail i datës 17.06.2021; E-mail i datës 09.06.2021; E-mail i datës 11.06.2021; E-mail i datës 25.05.2022; E-mail i datës 16.05.2021; E-mail i datës 03.06.2021; E-mail i datës 04.08.2021; E-mail i datës 13.04.2021; E-mail i datës 27.01.2021; E-mail i datës 26.01.2021; E-mail i datës 25.01.2021; E-mail i datës 15.10.2022; E-mail i datës 13.05.2022; E-mail i datës 10.05.2022; E-mail i datës 25.10.2022; E-mail i datës 10.02.2023; E-mail i datës 09.02.2023; E-mail i datës 02.11.2022; Komunikime përmes mesazhave ndërmjet B.S dhe V.C; E-mail i datës 02.04.2021; E-mail i datës 30.03.2021; E-mail i datës 29.03.2021; E-mail i datës 12.03.2021; Kërkesë për Auditim të Veçantë e datës 25.05.2021; E-mail i datës 26.05.2021; E-mail i datës 06.06.2022; Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2020; Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2021; E-mail i datës 28.06.2023; E-mail i datës 03.07.2021; E-mail i datës 04.07.2023; Raporti periodik i evidences së hyrjeve me vonesë dhe daljeve para kohe për periudhën 01.03.2023-31.03.2023; Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, *sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër të referencës Ref.07/04/8/2023 të datës 01.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë për shqiptimin e masës disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil", pretendon mos regjistrimi ka ndodhur për shkak që fillimisht si natyrë e punës në terren e pastaj shpesh herë edhe harresa e kartelës por duke u bazuar edhe në praktikën se Sekretarët e Përgjithshëm dhe Kryeshefat nuk regjistrohen asnjëherë dhe të gjithë ministrat, sekretarët e përgjithshëm dhe kryeshefat ekzekutiv kanë qenë të vetëdijshëm se një gjë e tillë ka ekzistuar dhe për këtë ka ekzistuar një aprovim në heshtje ngase për këtë nuk kam pasur ndonjë vërejtje verbale apo me shkrim për këtë; Lidhur me mos përmbushjen e detyrave të punës pretendon se janë të paqëndrueshme pretendimet e Komisionit Disiplinor, ngase zyra e auditimit është në mungesë të stafit dhe kapaciteteve të tjera përmes të cilave do të ishte më funksionale përveç kësaj kemi pasur pengesa në mungesë të veturave zyrtare, dhe këshillim të stafit.

Lidhur me pretendimet e iniciuesit të procedurës disiplinore për sa i përket vijueshmërisë në punë të ankuesit apo mos regjistrimit në sistemin e vijueshmërisë, po ashtu lidhur me rrjedhshmërinë e shqyrtimit të lëndës disiplinore ndaj ankuesit, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se ankuesi nga data 01.01.2022 deri më datë 30.04.2023 nuk është regjistruar në sistemin për menaxhimin e vijueshmërisë në punë, ndërlidhur me këtë çështje Ligji Nr.06/L-114 për Zyrat Publike, konkretisht neni 18 paragrafi 5, përcakton se: "5. Kriteret dhe kushtet e orarit të punës dhe të pushimeve përcaktohen nga Qeveria me akt nënligjor, pas

propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për punë”, andaj duke marr parasysh konstatimin se ankuesi nuk është evidentuar në punë nga data 01.01.2022, Kolegji i Këshillit, fillimisht ju referua dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë të cilat kanë qenë të aplikueshme deri më datë 12.10.2022, ku me nenin 8 paragrafin 1 të kësaj Rregullore është përcaktuar se: “Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtaret publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik”, ndërsa nga data 12.10.2022 është në fuqi Rregullorja (QRK) Nr. 07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, e cila në nenin 9 paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5, ka përcaktuar se: “1. Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë prezent në vendin e punës. 2. Çdo zyrtar publik është i obliguar që të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni. 3. Mosregjistrimi në librat e vijueshmërisë në punë apo në regjistrin elektronik, llogaritet si mosprezencë në punë. 4. Përgjegjës për vijueshmëri në punë të zyrtarëve publik, është mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 5. Mos respektimi i orarit të punës, sipas Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik paraqet shkelje disiplinore”.

Kolegji i Këshillit, bazuar në dispozitat e lartcekura, konstaton se të gjithë zyrtarët publikë duke filluar nga kategoria e nivelit të lartë drejtues deri tek kategoria e nivelit profesional janë të obliguar që përveç që të jenë prezent në vendin e tyre të punës duhet të regjistrohen në sistemin e menaxhimit të vijueshmërisë në punë qoftë përmes librit apo sistemit elektronik, dhe meqenëse Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është e integruar në sistemin elektronik atëherë zyrtarët publikë kanë qenë të obliguar të bëjnë regjistrimin përmes këtij sistemi, në këtë rast kjo ka vlejtur edhe për ankuesin në pozitën “Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm. Po ashtu bazuar në shkresat e lëndë, Kolegji ka gjetur se edhe përkundër njoftimit përmes emailit të datës 12.04.2023 të Drejtoreshës Ekezkutive të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, ankuesi ka vazhduar me mos regjistrim, kështu që pretendimi ankimor mbi këtë bazë nuk ka mbështetje ligjore, rrjedhimisht mos njoftimi si pretendohet nga ankuesi nuk përben shkak për lirim nga regjistrimi i vijueshmërisë në punë, andaj veprimet e ankuesit janë në kundërshtim me rregulloret e lartcekura dhe paraqesin shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Sa i përket pretendimeve të iniciuesit të procedurës disiplinore për mos përmbushje të detyrave të punës, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se sipas planifikimeve të auditimit të brendshëm për vitin 2021 janë planifikuar katër (4) fusha të auditimit ndërsa është përfunduar vetëm një raport i auditimit ai i datës 08.09.2021 dhe është për vetëm një fushë të auditimit, ndërsa për vitin 2022 në planin vjetor të auditimit janë planifikuar pesë (5) fusha të auditimit ndërsa nuk është ofruar asnjë raport final brenda këtij viti, fakt i vërtetuar edhe përmes raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2022 të kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit ku tek *Çështja A4-Mos aprovimi me kohë dhe mos realizmi i planit vjetor të auditimit në AZHB*, theksohet se *...sipas planit vjetor të punës për vitin 2022, NJAB kishte planifikuar të kryej pesë (5) auditime. Plani vjetor i auditimit të AZHB është aprovuar më 25.02.2023 nga Ministri, më vonë afërsisht*

dy muaj, Në vitin 2022, NJAB e AZHB-së nga pesë auditimet e planifikuara nuk kishte realizuar asnjë. Mos finalizimi i raporteve është konfirmuar edhe nga Komiteti i Auditimit në takimin e mbajtur me datë 27.12.2022. Rrjedhimisht, bazuar në faktet e lartcekura rezultoi se ankuesi nuk ka përmbushur detyrat e tij të përcaktuara me përshkrimin e detyrave të punës dhe planin vjetor të punës kështu që Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të rënda disiplinore të parapara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, të ndërlidhura me nenin 28 të këtij ligji i cili përcakton se: *“Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij”*.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, me rastin e parashtrimit të kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore, ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil”*, ndërsa Komisioni Disiplinor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër reference Ref.07/04/8/2023 të datës 01.06.2023, në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen e bërë nga ankuesi, në këtë rast ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ka konstatuar saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore si: *ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit*, po ashtu masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nenin 48 paragrafi 3, nenin 50 paragrafi 1, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 11, nenin 12, nenin 13 paragrafi 3, paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 dhe 4.2 dhe paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, në këtë rast komisionit Disiplinor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë përveç kësaj vendimin e ka nxjerr duke u bazuar në provat vendimtare që kanë të bëjnë më rastin konkret, dhe të njëjtin e ka arsyetuar në përputhje të plotë me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet të ankuesit ndaj këtij vendimi janë pretendimet të pabazuara dhe të pa argumentuar me prova konkrete.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.911/2023

Avdyll BEKTESHI

Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Gashi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtoreshës Ekzekutive në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.